



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË KORÇË TË PROPOZUAR
NGA PARTIA "BINDJA DEMOKRATIKE" Z. LEONARD OLLI PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 20.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë z. Leonard Nesim Olli të propozuar nga partia "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga partia "Bindja Demokratike" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr. 230, datë 24.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 partia "Bindja Demokratike".



Nr. 603 i Vendimit

Data 20.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë të propozuar nga Partia "Bindja Demokratike", z. Leonard Olli për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", partia "Bindja Demokratike" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z. Leonard Nesim Olli si kandidat për kryetar të Bashkisë Korçë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Korçë, pasi Bashkia Korçë, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për regjistrimin e z. Leonard Nesim Olli si kandidat për kryetar të Bashkisë Korçë;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Korçë, të propozuar nga partia "Bindja Demokratike" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 13 prot., datë 13.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se "z. Andi Përmeti, është deputet i Kuvendit të Shqipërisë, shpallur me vendimin nr. 179, datë 18.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe betuar në Kuvend më datë 25.04.2019. Ai zotëron mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor. Në deklarinim që ka bërë në Kuvend, sipas nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, rezultoi se deputeti z. Andi Përmeti është deklaruar "i pavarur" dhe që përfaqëson subjektin "Bindja Demokratike";
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 13 prot., datë 13.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se "z. Lefter Koka është deputet i Kuvendit të Shqipërisë, shpallur me vendimin nr. 555 datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe betuar në Kuvend më datë 09.09.2017 zotëron mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor";
5. Kopje e letërnjoftimit të z. Leonard Nesim Olli sipas së cilës rezultoi se z. Leonard Nesim Olli është me vendbanim në Bashkinë Korçë;
6. Jetëshkrimin e z. Leonard Nesim Olli, si kandidat për kryetar të Bashkisë Korçë;
7. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandiduar për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, z. Leonard Nesim Olli nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga Partia "Bindja Demokratike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 20.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar z. Leonard Nesim Olli, në Bashkinë Korçë, të depozituar nga Partia "Bindja Demokratike" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.



Nr. 603 i Vendimit

Data 20.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë të propozuar nga Partia "Bindja Demokratike", z. Leonard Olli për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Korçë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Leonard Olli të propozuar nga Partia "Bindja Demokratike".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 603 i Vendimit

Data 20.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë të propozuar nga Partia "Bindja Demokratike", z. Leonard Olli për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.